



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 6.2. 2020

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8577, DATË
10.02.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS
KUSHTETUESE”, TË NDRYSHUAR”**

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 6.2.2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relacione për shqyrtimin e projektligjit deputeten znj. Klotilda Bushka.

Në mbledhjen e Komisionit për të diskutuar mbi projektligjin, si dhe për të dhënë opinionin e tyre ishin të pranishëm, znj. Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë, z. Maksim Qoku, nënkryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Toska, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe përfaqësues të Misionit EURALIUS.

I. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një grup deputetësh, sipas nenit 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar synon zgjidhjen e situatës kur Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, i zgjedhur sipas nenit 125 të Kushtetutës, në rast mosveprimi të Presidentit të Republikës për të

organizuar ceremoninë e betimit, të mund të fillojë ushtrimin e detyrës të tij. Qëllimi i shtesave në ligj është ofrimi i një mekanizmi efektiv për të mos penguar në të ardhmen punën e Gjykatës Kushtetuese duke siguruar që betimi të bëhet brenda një kohe të mjaftueshme, pa cenuar fillimin e ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim që do të pengonte në formimin e trupës gjyqësore do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës.

Ky projektligj i jep mundësinë Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, që betimin e parashikuar në nenin 129 të Kushtetutës ta paraqesë/dërgojë në formë të shkruar pranë Presidentit të Republikës. Neni 129 i Kushtetutës e shikon personin e zgjedhur sipas nenit 125 të saj si gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese dhe kërkon që ai të kryejë betimin para Presidentit, përpara fillimit të ushtrimit të detyrës. Nisur edhe nga parashikimi i nenit 124 të Kushtetutës, sipas të cilit kjo gjykatë i nënshtrohet vetëm Kushtetutës, asnjëri nga institucionet e tjerë kushtetuese nuk duhet të ketë mundësinë, që të bllokojë fillimin e ushtrimit të detyrës nga një gjyqtar i kësaj gjykate.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Pas depozitimit dhe përfshirjes së dy nismave ligjore “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe “Për disa shtesa në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar në Kalendarin e Punës së Komisionit për Çështjet Ligjore, këto nisma i janë përcjellë për mendim Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Shkollës së Magjistraturës, shoqatës së gjyqtarëve, Fakultetit të Drejtësisë, UT, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Fondacionit SOROS, Res Publica, Institutit të Studimeve Politike dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Paralelisht me kërkesën për dhënien e mendimeve, për diskutimin e projektligjeve është ngritur edhe një grup pune me përfaqësues të disa prej institucioneve të sipërcituara dhe me asistencën e misionit EURALIUS.

IV. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT

Sipas nenit 129 të Kushtetutës : *“Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës.”* Bërja e betimit sipas Kushtetutës dhe ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, konsiderohet edhe momenti i fillimit të detyrës për gjyqtarin e e Gjykatës Kushtetuese.

Projektligji synon të rregullojë situatën kur Presidenti i Republikës nuk vepron për të organizuar ceremoninë e betimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke cenuar në këtë mënyrë fillimin e ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe mirëfunksionimin e këtij organi kushtetues.

Projektligji, duke respektuar parashikimin e dispozitës kushtetuese për betimin e gjyqtarit, përcakton një procedurë të posaçme të betimit me shkrim vetëm në raste përjashtimore, kur Presidenti nuk e ushtron kompetencën që i ka dhënë Kushtetuta për të organizuar ceremoninë e betimit. Vendosija e një afati për realizimin e ceremonisë së betimit si dhe parashikimi i mekanizmit zhblllokues, pra realizimit me shkrim të betimit, nuk cenon kompetencat e presidentit të Republikës, por synon të sigurojë funksionimin normal të organit kolegjal, Gjykatës Kushtetuese. Neni 129 i Kushtetutës ruan në mënyrë të padiskutueshme epërsinë në bërjen e betimit, dhe rregullimi me ligj mbetet si një rast tërësisht përjashtimor.

Propozimi i këtij projektligji vjen në përputhje me qëndrimin e Komisionit të Venecias, i cili në opinionin e tij të datës 22 Qershor 2006, CDL-AD (2006)016-e, ka trajtuar një rast të ngjashëm me Gjykatën Kushtetuese së Ukrainës. Në Opinionin e tij Komisioni i Venecias shprehet se: *“...në vendet ku është krijuar, gjykata kushtetuese është një institucion me rëndësi thelbësore në sigurimin e funksionimit të organeve shtetërore, brenda kufijve kushtetues. Ato kanë funksionin kryesor për të garantuar respektimin e parimeve themelore të demokracisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, të cilat janë gjithashtu standardet themelore të Këshillit të Evropës.... **Autoritetet shtetërore të përfshira në procedurën e kompozimit të Gjykatës kanë detyrimin kushtetues për të siguruar vazhdimësinë dhe stabilitetin e punës së Gjykatës**”.*

Në vazhdim, lidhur me procedurën e betimit, Komisioni i Venecias shprehet se: *“Një procedurë efektive e emërimit nuk përbën garancinë e vetme për të shmangur bllokimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, Të metat në lidhje me mekanizmin e fillimit të detyrës mund të pengojnë punën e Gjykatës. Prandaj, çështja e administrimit të betimit duhet të trajtohet. Objektivi kryesor duhet të jetë siguri që betimi të bëhet në kohën e duhur dhe procedura e betimit të mos rezultojë në formalitete që mund të rrezikojnë fillimin e detyrës së gjyqtarit.....**Një nga zgjidhjet në këtë drejtim mund të jetë betimi në formë të shkruar dhe dorëzimi i tij Presidentit, ose Kryetarit të Parlamentit.**”*

Kushtetuta, nëpërmjet neneve 6 dhe 81/2/a të saj, ia nënshton rezervës ligjore absolute çështjen e organizimit dhe të funksionimit të organeve dhe institucioneve të parashikuara prej saj, duke i njohur dhe lënë hapësirë Kuvendit që të rregullojë këtë çështje/marrëdhënie.

Bazuar në standardin kushtetues se është brenda hapësirës vlerësuese të ligjvënësisë mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, është bërë dhe propozimi i shtesave në ligjin organik të Gjykatës.

Edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur se : **“Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Edhe pse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t’u parashikuar nga ligje ose**

akte të tjera normative, sipas rastit (shih vendimin nr.22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

V. NDRYSHIMET E MIRATUARA NË KOMISION

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, duke marrë parasysh rekomandimet dhe propozimet e paraqitura nga relatorja dhe grupi i punës, me qëllim harmonizimin me dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nga pikëpamja e teknikës legislative, miratoi këto ndryshime:

- Neni 1 i projektligjit të riformulohet si vijon:

“Neni 1

Në nenin 8, pika 1, shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Presidenti i Republikës organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjes, emërimit ose shpalljes të emëruar të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk thirret për të bërë betimin, pas përfundimit të këtij afati, ai kryen betimin në formë të shkruar dhe ia dërgon atë Presidentit të Republikës, organit të emërtesës dhe Gjykatës Kushtetuese. Data e ceremonisë së betimit ose data e dërgimit të betimit me shkrim, konsiderohet si data e betimit dhe e fillimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.”

- **Neni 2** i projektligjit u tërhoq nga propozuesit e projektligjit gjatë shqyrtimit në Komision, pasi kjo është një nga çështjet për të cilat i është bërë kërkesë Komisionit të Venecias.

Heqja e këtij neni reflektohet dhe në titullin e projektligjit, që bëhet “Për një shtesë në ligjin.....”.

VI. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, e miratoi me ndryshimet e paraqitura nga relatorja, dhe ia përcjell për votim seancës plenare.

RELATORE

KLOTILDA BUSHKA

KRYETAR

ULSI MANJA